

IVALDA PACI

**RRETH DISA ELEMENTEVE TEKSTORE NË OFICEN E VOGËL
TË ZOJËS NË *MESHARIN* E GJON BUZUKUT (1555)**

Në pikëpamje të një vështrimi tekstologjik dhe filologjik, mjaft pjesë nga libri i Gjon Buzukut paraqesin interes studimi dhe ofrojnë mundësi qasjeje si në kontekstin e vetë librit në fjalë, ashtu dhe me variante apo modele të cilat ishin pjesë e praktikës së liturgjisë në kohën kur mendohet se është shkruar ky libër. Pothuaj në çdo sprovë studimore për ta parë në këtë këndvështrim librin e Gjon Buzukut, është vënë në dukje fakti që pjesë të caktuara të tij dallohen për një numër të madh fjalësh të huaja apo dhe për përdorime që dëshmojnë qartë ndikimin e autorit nga gjuhët e huaja që mund të njihen dhe konsultonte.

Tekste të caktuara nga *Meshari* i Gjon Buzukut në të vërtetë përbëjnë më të parat variante të shkruara të krijimeve që janë të pranishme në libërthata e liturgjisë së krishterë e në veçanti në praktikën e liturgjisë së orëve. Përveç faktit që disa forma të veçanta janë gjurmuar së pari në të tilla tekste, gjendja e tyre pikërisht në trajtat në të cilat i ndeshim në përbërje të *Mesharit*, i jep rrugë përvijimit të një diakronie jo vetëm gjuhësore e që ka të bëjë me këngët e festave të paluajtshme, me himnet liturgjike, që autori i ka sjellë në format e disponueshme në kohën kur jetoi e gjithashtu me lutje themelore, që dhe sot e kësaj dite, në zona të caktuara të vendit tonë e në ndonjë areal jashtë Shqipërie, mund të gjurmohen në forma e ndërtime të përafërta.

Në Oficën e Vogël të Zojës e që përbën pjesën e parë të librit të Gjon Buzukut, të tilla tekste gjurmohen në më se një variant të mundshëm. Përveç varianteve interesante të lutjes *Ati Ynë*, të vënë në dukje në plan përqasës dhe nga Atë Justin Rrota në vazhden e gjurmimeve të tij tekstologjike mbi librin në fjalë, mund të trajtohen në këtë pikëpamje dhe këngë tipike të natyrës himnodike si: *Salve Regina*¹, *Regina coeli*², *Memento rerum conditor*³ etj. Përmbajtja e këtyre komponimeve mund të qaset si me variante të mëvona të praktikuar gjatë e

¹ *Meshari, botim kritik përgatitur nga E.Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f.31/b; *Meshari, botim i cituar, po aty*, f.41/a-b.

² *Meshari, botim kritik përgatitur nga E.Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f.31/b: *Regjina e qiellsë, gëzou, Aleluja; përse atë qi meritove ndë bark me bartunë, Aleluja, resushitoi, si tha, Aleluja.*

³ Për një shembull të gjetjes fragmentare të këtij himni pikërisht në faqet e para të disponueshme të librit shih në veçanti *Meshari, botim kritik përgatitur nga E.Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f.13/a: *O e shenë Mëri hirplota, Ama e përmishëriershime, ti neve në anëmikut na ruoj, e në ditet së mortës sanë na përze.Lavdi ty kloftë, qi je lëm në Virgjënet, me na qitunë jashtë ferënë, e jet përherë me Atët bekuom e me Shpirtinë shenjtë, për jetë të jetësë. Amen.*

tradicionalisht në gegnishten veriore, ashtu dhe me variante në gjuhën latine nga të cilat mendohet se mund të jenë përshtatur për t'i sjellë në formën apo format në të cilën paraqiten në librin e Buzukut.

Memento rerum conditor përbën në veçanti një prej varianteve tekstore me të cilin qasemi më shpesh në faqet e pjesës së parë të këtij libri, duke qenë se në çdo shfletim të saj bie në sy shpeshësia e rimarrjes së tij në paragrafe të caktuara të Offices.⁴

Ndër të tjera, kjo rimarrje lejon dhe vënien në dukje të formave që përbëjnë modifikime të lehta përmbajtësore në përmbajtjen e himnit në fjalë:

Rekordou, o *Bāsi* i gjithë shekullit, ñ së shelbuomit sinë, qi ñ motit së shkuom more formë ndë korp uman me vertyt tande me lem ñ Virgjënet. O Mëri hirplota, Ama e përmishëriershime, ti neve ñ anëmikut na defendo, e ñ ditet së mortisë sanë ti neve na përze.⁵

Nga variantet e himnit kushtuar krijuesit, pikërisht në këtë të mësipërmin tërheq vëmendjen një model formimi i shqipes: *Bāsi*,⁶ të cilit në latinishte pikërisht i përgjigjet një tjetër model prejardhjeje në pikëpamje të formimit: *conditor*.⁷ Bëhet fjalë për një model formimi që më tej do të vërehet se pasqyrohet dhe në emra të tjerë veprimi, një pjesë e mirë e të cilëve i përkasin dhe një sferë të përafërt semantike.⁸ Tipologjia në fjalë e modelit të formimit të këtyre emrave gjurmohet në rritje pikërisht në variante të mëvona doktrinare, ndërkohë që

⁴ Për një trajtim më të thelluar të këtij teksti të rëndësishëm në faqet e Offices dhe në pikëpamje qasëse me ndërtime e tekste gjegjëse në gjuhën latine shih dhe E. Paci, *Inni e preghiere nel Messale di Gjon Buzuku*, në *Classica e Christiana*, 6/2, 2011, f.579-581.

⁵ Meshari, *botim kritik i cituar*, f. 19/b. Për një variant të përafërt me ndonjë modifikim të lehtë të tekstit shih dhe *po aty, botim kritik i cituar*, f.21/b: Rekordou, o Bāsi i gjithë shekullit, ñ së shelbuomit sinë, qi ñ motit së shkuom formë more ndë korp uman, me vertyt tande me lem ñ Virgjënet Mëri. O Mëri hirplota, Ama e përmishëriershime, ti neve ñ anëmikut na defendo, e ñ ditet së mortisë sanë neve na përze.

⁶ Meshari, *botim kritik i cituar*, f. 17/b: *O Autore*, kujtoui ñ së shelbuomit sinë, qi ñ motit së shkuom formë more ndë korp uman, me vertyt tande me lēm ñ Virgjënet. O Mëri hirplota, Ama e përmishëriershime, ti neve ñ anëmikut na defendo, e ñ ditet së mortisë sanë ti na përze. Lavdi kloftë ty, Zot, qi jë lem ñ Virgjënet, me na qitunë jashtë ferënë, e renjon përherë me Atët bekuom e me Shpirtinë shenjtë, për jetë të jetësë.

⁷ Për foljen gjegjëse latine *condo*, *condere* tr.-fondare, edificare, fabbricare; dhe emrin *conditor*, *conditoris* m.-facitore, autore, conditore, fondatore, shih dhe T. Vallauri - C. Durando, *Dizionario della lingua latina*, Zeus editoriale, 1996, f. 137. Pas vënies në dukje të një fakti të tillë të qartë, mendojmë se vëmendja duhet drejtuar ndaj varianteve referenciale që mund të ketë konsultuar apo vendosur të vërë në përdorim autori i librit, duke qenë i ditur dhe fakti që dhe në tekstet në latinishten kishtare ky himn mund të ndeshet në më tepër se në një variant tekstor. Himni vetë qëndron natyrshëm në përbërje të Offices së Zojës dhe vetë ndërtimi në gjuhën shqipe që shfaqet në një emër veprimi e që ndeshet në më se një variant të tij përfaqëson një ndërtim që duhet të jetë i ngulitur në kohën e përpilimit të Mesharit.

⁸ Lidhur me citimin e këtij emri veprimi në studimet shqiptare shih në veçanti E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes II, A-B*, Tiranë, 1976, f. 111.

Rreth disa elementeve tekstore në Oficen e Vogël të Zojës ...

rezulton se ruhen forma analitike gjithmonë në përbërje të nënsistemit emëror të shqipes.

Oficja e Vogël e Zojës (Officium Parvum Beatae Mariae Virginis) përbën një prej pjesëve më të gjurmueshme në pikëpamje tekstesh të veçanta, duke qenë konceptuar kjo e fundit si tërësi elementesh tekstore që i bashkon një fill tematik i qartë. Edhe pjesët biblike që rimerren në këtë pjesë, i referohen figurës qendrore të Offices, Mërisë, siç emërtohet në tekstet e *Mesharit* të Gjon Buzukut. Pas fragmentit nga Ungjilli sipas Lukës,⁹ në të cilën Mërisë i paralajmërohet lindja e Mesisë, një sërë tekstesh të tjera si lutje (orationes)¹⁰, këngë tipike, himne etj., i referohen këtij motivi: shpalljes së këtij lajmi, i ndeshur dhe në vepra të tjera të së njëjtës tradite shkrimore në variante tekstore po aq të veçanta, ndër të cilat për veçanti pa dyshim do të përmendim dhe ato variante që ndeshen në faqet e *Mesharit* tonë.¹¹

Një arsenal i tërë emërtesash dhe atributesh lidhet me figurën e Mërisë, *Amës së Tinëzot*, siç dhe quhet në një mënyrë vërtet origjinale në faqet e Offices. Në himnin e mirënjohur *Ave maris stella*,¹² megjithëse bie në sy një numër i madh fjalësh të huaja në përpjesëtim me vetë gjatësinë e tekstit të këtij komponimi, nuk mund të mos vihet në dukje prirja për t'i dhënë atij një frymë poetike. Dhe në këtë tekst sintetik lexohet qartë filli tematik i paralajmërimit të lindjes së Mesisë, që i përshtatet frymës së mbarë Offices së Zojës:

Ty të ɳfalemì, o uilli i detit, e Amë e denjë e Tinëzot, tue mbetunë përherë Virgjënë, dera feliçe e regjinisë qiellsë. *Tue pasunë ata të ɳfalë ɳ gojet së Gabrielit*; ti neve na shtjerë ɳdë paq, tue nderunë emënitë e Jevësë. E zgjidh të ɳlidhunatë e këqia të t bākëqivet, tue dhanë dritë d verbënet, e neve tue na hjekunë të këqiatë e tue na dhanë të miratë. E ti neve na u dëfto pr amë, e oratëtë tonë i përzantë aj qi për ne anshtë lenë e uit Bir zgoth me klenë. Një e vetëmeja Virgjënë, e ɳdër gjithë to mā e përvuta, neve ɳdë kastitat na ep gjellënë të pa

⁹ Për këtë pjesë biblike nga Ungjilli sipas Lukës (Luka, 1, 26-38; Luka 1, 29-38) dhe çështjen e rimarrjes në pjesë të tjera të Offices, shih në veçanti, *Meshari, botim kritik i cituar*, bashkë me shënimet përkatëse në lidhje me këtë fakt nga E. Çabej, përkatësisht në faqet 33 e më tej të pjesës së dytë të këtij botimi kritik. Në këtë pjesë ungjillore mund të gjurmohet dhe *incipit-i* i himnit *Ave Maria*: Zotynë t u ɳfaltë, Mëri hirplota, e Zotynë me ty kloftë; ti je e bekuome ɳdër grāt. Duhet vënë në dukje fakti që kjo pjesë ungjillore rimerret dhe në variante doktrinare e kateketike, e konkretisht në ato në gjuhën shqipe që pasojnë librin e Buzukut me modifikime të mundshme sa u takon disa përdorimeve emërore apo foljore.

¹⁰ Përveç teksteve të sipërcituara që në mënyrë të thukët do të ceken në këndvështrimin e një kumtimi sintetik, duhet vënë në dukje që dhe lutje të tjera që përmbahen në këtë pjesë të librit të Buzukut përçojnë të njëjtën tematikë që përcillet nga vetë pjesët biblike tipike, këngët dhe komponimet e tjera të cituara.

¹¹ Në lidhje me rimarrjen e këtij motivi në Doktrinën e Gjon Nikollë Kazazit shih dhe B. Demiraj, *Gjon P. Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2006, f. 375: Nje shërbëtoreja e Tinëzot: m' u banft mue, si thot fiala jote.

¹² *Meshari, botim kritik përgatitur nga E. Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 27/a-b.

ndonjë diekeqi, e neve na ep udhënë seure me Jezunë Birë tand, qi me sisat të tū ushqeve, përherë na ndaj të me klenë.¹³

Duke qenë një tekst që rimerret më se një herë në përbërje të Offices, *Salve Regina* bie në sy për ndonjë diferencim të mundshëm formal sa i takon përdorimit të fjalëve të caktuara të këtij teksti.¹⁴ Besojmë se duhet vënë në dukje që mes gjinore e *mishëriersë* (që përbën një përkthim *ad litteram* të gjinore latine gjegjëse) dhe mbiemrit mjaft interesant në pikëpamje të formimit por dhe kuptimit e *përmishëriershime* njëfarë diferencimi të natyrës semantike. Në pamje të parë gjinorja e sipërpërmendur përputhet në pikëpamje formale me genitivin latin përgjegjës *miseriordiae*, por nga ana tjetër, gjithnjë nëse duhet t'i përmbahemi këtij aspekti që synon pikërisht të qasja mes varianteve modeste të kësaj kënge mjaft të përdorur në liturgjinë e orëve brenda librit të Buzukut, duhet dhënë një gjykim dhe mbi faktin nëse mund të përbëjë diferencim leksikor përdorimi i gjinore nga përdorimi i mbiemrit e *përmishëriershime*, duke qenë ky i fundit një prej mbiemrave më tipikë në pikëpamje kuptimore dhe fjalëformimi nga leksiku i liturgjisë të pranishëm në librin e Gjon Buzukut.¹⁵

Në lidhje me këtë personazh qendror të Offices (Mërinë), mund dhe të vihet në dukje që janë në përdorim një sërë mbiemrash (dhe të emëruar gjithashtu) të veçantë nga pikëpamja semantike e që i referohen kësaj figure femërore: e *bekuome*¹⁶ / e *bekuomeja*, e *përvutë*, e *përmishëriershime*, e *ambla*¹⁷, *klemente*¹⁸, e *glorifikuome*¹⁹, e *shëkrume*²⁰ etj.

Ndër këto ndërtime të sipërpërmendura, mund të veçohet dhe ndërtimi *hirplota*, i pranishëm si në *incipit*-in e lutjes *Ave Maria* (që e gjejmë në *tekstin e*

¹³ Meshari, *botim kritik i cituar*, f. 27/a-b.

¹⁴ Për njërin prej varianteve të këtij komponimi shih pikërisht *Meshari, botim kritik përgatitur nga E. Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 31/b: Zotynë t u nfalltë, o Regjina e mishëriersë; gjellë e të *amblë*, e shpënesa jonë, Zotynë ty t u nfalltë. M ty thëresmë na të bandizuom të bijtë e Jevësë. M ty fshanjëme, tue gjmuom e tue klanë mbë këtë shekullë plot me lot. O gojëtareja jonë, ata sytë e tū të përmishëriershim rutullo prej nesh. E Jezunë, frujtinë e barkut tit të bekuominë, mbassi të shkojmë këtë jetë, neve na dëfto. O e përvutë, o e përmishëriershime, o e ambla Virgjënë Mëri.

¹⁵ Mbi përdorimin e këtij mbiemri në librin e Gjon Buzukut shih dhe E. Paci, *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut* (punim monografik), Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011, përkatësisht në f. 136; f. 140.

¹⁶ Meshari, *botim kritik përgatitur nga E. Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 27/b: **E bekuome** Amë, e **pāmartuome**, e **madheja** Regjinë e shekullit, lut Tenëzonë për në.

¹⁷ Meshari, *botim kritik përgatitur nga E. Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 31/b: **O e përvutë, o e përmishëriershime, o e ambla** Virgjënë Mëri.

¹⁸ Meshari, *botim kritik përgatitur nga E. Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 41/b: **O klemente, o e përmishëriershime, o e ambla** Virgjëna Mëri.

¹⁹ Meshari, *botim kritik përgatitur nga E. Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 31/a: ... të lutunitë tanë, na kur ty të të lusmë ndë nevojët tonë, mos i deshpëlqe, ma n qishdota perikullë neve na libero përherë, o Virgjëna e **glorifikuome** e bekuome.

²⁰ Meshari, *botim kritik i cituar*, f. 17/a; f. 35/b: Denjou u ty të të lëvdonj, o Virgjëna e **shëkrume**.

Rreth disa elementeve tekstore në Oficen e Vogël të Zojës ...

fragmentit nga Ungjilli simbas Lukës), ashtu dhe në atributet që Virgjënës i jepen në përmbajtjen e himnit të sipërpërmendur *Memento rerum conditor*²¹, ndërtim që na paraqitet si te *Meshari* ashtu dhe më tej në një formë sintetike, ndërkohë që i përgjigjet sintagmës latine *gratiā plena*, kjo e fundit ndërtuar mbi bazën e një rrjedhoreje pa parafjalë.²²

Në tekstet e Offices bien në sy një sërë zërash të pashqipëruar, ndër të cilat disa me vlerë të qartë terminologjike²³, veçori kjo e vënë në dukje dhe më parë nga studiuesit e këtij libri. Shtojmë këtu dhe përdorime që në ditët e sotme e kanë gjetur gjegjësin në gjuhën shqipe: *nuncio*²⁴ / *(tue)nunciuom*²⁵, *resushitoi*²⁶ etj.

Në proces të gjurmimit të këtyre teksteve vihen re dhe ndërtime që më tej do të jenë në vijimësi përdorimi në përbërje të librit e që, gjithashtu, do të jenë zëra të përbashkët përdorimi në veprat e mëvona të kësaj letërsie: folje që ruajnë qartë lidhjen me origjinën latine e që për studiuesit e teksteve të vjetra shqipe e të disiplinave studimore filologjike janë bërë objekt studimi në pikëpamje kryesisht etimologjike (p.sh., folja *fëje*, e pranishme si në tekstet e mëtejme të librit (veçanërisht te pasthënia e librit, kolofoni²⁷), ashtu dhe në autorët e tjerë të së njëjtës traditë shkrimore).

Në zërat antifonare mbizotërojnë vargje nga tekstet e Besëlidhjes së Vjetër, të cilët dhe janë bërë jo rrallë objekt shqyrtimi në fushë të studimeve teologjike sa u

²¹ *Meshari, botim kritik përgatitur nga E. Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 13/a: **O e shenë Mëri hërplota**, Ama e përmishëriershime, ti neve ñ anëmikut na ruoj, e ñ ditet së mortës sanë na përze.

²² *Meshari, botim kritik përgatitur nga E. Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 31/b: Zotynë ty t u ñfaltë, **o hirplota**, Zotynë me ty.

²³ *Meshari, botim kritik përgatitur nga E. Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 31/b: Këjo Antifenë perposh thuhetë **mbë Kompletët** mbas Pashkësh djerie mbë Oktavët të Pentekostës...

²⁴ *Meshari, botim kritik përgatitur nga E. Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 41/a: Engjëlli i Tinëzot **nuncio** Mërinë.

²⁵ *Meshari, botim kritik përgatitur nga E. Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 41/a: Oratio: o Zot, qi ñ zemëret së shenë Mërisë Virgjënë deshe Birë tand, engjëlli atë **tue nunciuom** aj të përzij korp ñ nieriu: hër bân atyne qi ty të lutene, përse si na për të vërtetë besojmë ajo me klenë Ama e Tinëzot, ashtu na përpara ty për të lutunatë të saj të jemi ñdimuom. Shih dhe interpretimin përkatës të zërave *nunciatë* dhe *nuncioj* në E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, VI, Tiranë, 2002, f. 96.

²⁶ *Meshari, botim kritik përgatitur nga E. Çabej, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 31/b: Regjina e Qiellsë, gëzou, Aleluja; përse atë qi meritove ñdë bark me bartunë, Aleluja, **resushitoi**, Aleluja.

²⁷ Me kuptimin *mëkatnoj* ndeshet kjo folje në veçanti në Decem precepta Dei (*Meshari, botim kritik i cituar*, f. 61-65); gjithashtu dhe te *De septem operibus misericordiae (po aty*, f. 65-69). Sa i takon përdorimit me kuptimin *gaboj, bëj gabim* të kësaj foljeje shih pikërisht *Meshari, botim kritik i cituar, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 387: E se për fat në keshë kun mbë ndonjë vend **fëjyem**, u duo tuk të jetë fajtë, aj qi të jetë mǎ i ditëshim se u, ata faj e lus ta trajtonjë ñde e mirë. Përse nukë çuditëm se në **paça fëjyem**, këjo tue klenë mǎ e para vepërë e fort e fështirë për të vepëruom mbë gluhët tanë.

takon lidhjeve të qarta tematike me tekste të caktuara të Besëlidhjes së Re. Në këta zëra vihen re dhe vargje nga psalmet (gjithashtu dhe nga Isaias, Ecclesiasticus²⁸, Liber Sapientiae, Canticum Cantorum²⁹), fakt ky që e afron Oficen e *Mesharit* tonë me modelet referenciale të asaj kohe dhe me modele të mëvona në pikëpamje kronologjike.

Nga ana tjetër, veçanërisht në rastin e Offices, vëmë në dukje që dhe fjalë të caktuara për të cilat janë zgjedhur trajta të afërta me latinishten apo italishten e kohës së tij, më tej do të zëvendësohen natyrshëm me gje gjëset në shqipe.

Sa u takon teksteve biblike që përmbahen në Office e që u përmendën më sipër (mbizotërojnë pjesë nga Ungjilli simbas Lukës), duhet vënë në dukje që japin mundësi të gjendet një linjë përqsasjeje me modalitetin tekstor të introduktimit të tyre në variantet biblike të mëvona e ato të ditëve të sotme. Nga ana tjetër, nuk duhet lënë pa vënë në dukje gjithashtu që të njëjtat tekste dhe mund të rimerren në përbërje të *Mesharit*, në pjesën mbizotëruese të librit, përkime këto që të vëna re nga studiues të vëmendshëm të aspekteve filologjike të gjurmimit të librit, japin hapësirë për krahasime në fushë të shqipërimit të teksteve dhe vënies në dukje të diversitetit në drejtim të disa zgjedhjeve dhe zgjidhjeve nga ana e autorit të librit.

Dhe në këtë trajtesë të thukët që ka të bëjë me një sërë tekstesh të rëndësishme nga libri i Buzukut, më saktë nga një pjesë e rëndësishme e përmbajtjes së tij, është me vend të ringrihet çështja e varianteve referenciale që mund të jenë konsultuar nga autori. Për këdo që ndërmerr hulumtimin e kësaj pjese me të cilën introduktohet tradicionalisht një libër orësh i asaj periudhe, është krejt e qartë çështja e teksteve që vërtet rimerren në paragrafe të ndryshme të librit, por mbartin dukshëm diferencime në drejtim të fjalëve e trajtave të caktuara në përmbajtjen e tyre. Në raste të caktuara vjen me vend dhe pyetja nëse autori ka vënë në përdorim të përpilimit të kësaj veprë komplekse variante të ndryshme nga gjuhë të ndryshme, duke qenë se rezultojnë në to diferencime të qarta në drejtim të përzgjedhjes së fjalëve apo ndërtimeve gjuhësore të caktuara.

Në këtë pikëpamje dhe tekstet biblike që janë sjellë në *Meshar* paraqesin interes veçanërisht në këtë drejtim, duke qenë se në proces të hulumtimit të tyre bie në sy fakti që autori duhet t'u jetë referuar burimeve të ndryshme ndërsa i përpilonte dhe i gatiste për botim.

²⁸ *Meshari, botim kritik i cituar*, f. 19/a: E ashtu u firmuoshë ndë qytet të santifikuome, e ashtu pushova; e ndë Jerusalem anshtë shkambi em. Shih gjithashtu *Meshari, botim i cituar*, f. 21/a: E lëshova ranzëtë ndë popullit të ndershim, e ndë pjesët të Zotit tim e ndë ereditatit të ti, e ndë shumicët të shenjtet anshtë të mbetunitë tem. Shih gjithashtu *Meshari, botim i cituar*, f. 27/a: Ñ së zanët nfill e parë se ish shekulli zanë u jam kriuum, e për jetë të jetësë qi kã me ardhunë u të mos mëngonj; e nde e mbetunit shenjtë përpara atë u sherbeva.

²⁹ *Meshari, botim kritik i cituar*, f. 15/b: Kush ë këjo qi vjen porsì drita qi zbardhetë, e bukurë porsì ana, e zgjedhunë porsì dielli, e madhe porsì ushtëria qi anshtë trajtuom për luftë?

Rreth disa elementeve tekstore në Oficen e Vogël të Zojës ...

Të tilla përdorime, dhe kur ndërtohen mbi fjalë prej burimi të huaj, marrin konotacion të veçantë pikërisht për faktin se janë elemente tekstore të komponimeve në fushë të himnodisë liturgjike.

Në pikëpamje të pasurisë gjuhësore, në këto tekste të Ofices gjurmohen fusha të tëra semantike që lidhen me nomenklatura të ndryshme: që nga emërtime bimësh, zogjsh e kafshësh që përmenden në psalmet biblike e pjesë të tjera nga Besëlidhja e Vjetër³⁰, deri te nomenklatura e sakrales që ndeshet me fjalë të përafërta dhe të pranëvëna dhe në ndonjë tekst specifik të kësaj pjese.³¹

Çdo vështrim mbi këtë pjesë të librit të Buzukut mendojmë se vë në dukje veçantitë e tij në disa pikëpamje: në pikëpamje të vetë modelit strukturor që qëndron në themel të tij si dhe lehtësisë që mund të kishte paraqitur për praktikën liturgjike të kohës duke qenë se përmbledh në vetvete një sërë librash kishtarë të destinuar për këtë praktikë, përfshirë atë të liturgjisë së orëve dhe ushtrimit të sakramendeve; në pikëpamje të një diversiteti të dukshëm gjuhësor që gjurmohet pikërisht duke kaluar nga një pjesë në tjetrën të këtij libri; gjithashtu dhe në kontekstin më të gjerë në të cilin ai e ekspozon dhe e projekton gjuhën dhe shkrimin shqip të asaj kohe.

BIBLIOGRAFI

- E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, BUSHSHT, nr. 3, 1963.
E. Çabej, *Studime gjuhësore VI (Gjon Buzuku dhe gjuha e tij)*, Botime Rilindja, Prishtinë, 1977.
E. Çabej, *Studime shqiptare, Veptra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
E. Çabej, *Shqipja në kapërcyell-Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.
E. Çabej, *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në BUSHT, nr. 2, 1959.
E. Paci, *Cenni ed osservazioni linguistiche sul primo libro scritto in lingua albanese (1555)*, në *Studia Albanica*, nr.1, 2014.
E. Paci, *Inni e preghiere nel Messale di Buzuku (1555)*, në *Classica et Christiana* 6/2, 2011.
E. Paci, *Kolofoni në Mesharin e Gjon Buzukut*, në *Hylli i Dritës*, nr. 1, 2012.
E. Paci, *Le Missel de Gjon Buzuku, un ouvrage fondamental pour l'histoire des écrits anciens albanais*, në *Studia Albanica*, nr. 1, 2012.
E. Paci, *Letërsia e vjetër shqipe në kontekstin e historisë së letërsisë shqiptare*, në *Hylli i Dritës*, nr. 2, 2011.
E. Paci, *Për një vështrim tekstologjik të Mesharit të Gjon Buzukut*, në *Hylli i Dritës*, nr. 3, 2011.
E. Paci, *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut* (punim monografik), Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011.
E. Sedaj, *Shqipja arbërore (në fillimet e filologjisë shqiptare)*, Prishtinë, 2002.

³⁰ *Meshari, botim kritik i cituar, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1968, f. 23/b: Capitulo: Një pjacat porsì *cinamomi* e porsì *balsami* qi ka erë të bukurë u dhae erënë, e porsì *mira* me erë t amblë u e dhae nde e pëlqyem erënë.

³¹ I referohemi në këtë rasë njërit prej psalmeve të pendesës, pikërisht në *Meshari, botim kritik i cituar, Pjesa e dytë*, f. 45/b.

- I. Zamputi, *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, në *Hylli i Dritës*, nr. 1-2, 1995.
- I. Zamputi, *Les circonstances historiques de la parution du "Missel" de Gjon Buzuku et sa place dans la littérature albanaise*, në *Studia Albanica*, nr. 1, 1988.
- I. Zamputi, *Mbi rrethanat historike të botimit të Mesharit të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare*, në "Studime filologjike", nr. 3, 1986.
- J. Rrota, *Per historin e alfabetit shqyp dhe studime tjera gjuhesore*, Botime Françeskane, Shkodër, 2005.
- K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe I*, Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi, Shkodër, 1996.
- K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Botime Toena, Tiranë, 2002.
- K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe III*, Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi, Shkodër, 2000.
- K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe IV*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2002.
- M. Camaj, *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960.
- M. Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais*, Librairie orientaliste P. Geuthner, Paris, 1932.
- P. Bogdani, *Cuneus prophetarum (botim kritik i përgatitur nga A. Omari)*, Tiranë, 2005.
- P. Budi, *Poezi (1618-1621), (botim kritik përgatitur nga R. Ismajli)*, Rilindja, Prishtinë, 1986.
- P. Budi, *Poezi (Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R. Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- R. Ismajli, *Tekste të vjetra*, Botime Dukagjini, 2000.